



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMITETI I INVESTIMEVE STRATEGJIKE

V E N D I M

NR. 27/2, DATË 20/11/ 2017

PËR SHQYRTIM TË MËTEJSHËM NGA MINISTRIA E TURIZMIT TË KËRKESËS PËR PËRFITIM TË STATUSIT "INVESTIM/INVESTITOR STRATEGJIK PROCEDURË E VEÇANTË" PËR PROJEKTIN E INVESTIMIT "KEPI MERLIN ECO RESORT"

Në mbështetje të Nenit 9 të Ligjit Nr. 55/2015, "Për Investimet Strategjike në Republikën e Shqipërisë" dhe Kreut II, pika 8 e VKM Nr. 1026, datë 16.12.2015, Komiteti i Investimeve Strategjike,

VENDOSI:

1. Shqyrtim i mëtejshëm nga ana e ministrisë përgjegjëse për turizmin mbi kërkesën për përfshirjen e projektit investues "Kepi Merlin Eco Resort", me subjekt investues "Bojken shpk" NUIS K11718001R në procedurën e veçantë.
2. Ministria përgjegjëse për turizmin, brenda 30 (tridhjetë) ditësh të analizojë nëpërmjet një grupi pune dokumentacionin dhe situatën e këtij projekti dhe të kërkojë dokumentacion shtesë nga aplikuesi, në rast se e shikon të nevojshme.
3. Pas analizës, ministria përgjegjëse për turizmin, dorëzon raportin e vlerësimit tek Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve, e cila në cilësinë e Sekretariatit Teknik të KIS, përgatit raportin final të vlerësimit për projektin "Kepi Merlin Eco Resort" për ta paraqitur në mbledhjen e radhës së KIS.
4. Vendimi i KIS publikohet dhe regjistrohet në Regjistrin e Investimeve Strategjike dhe i njoftohet me shkrim kërkuarit nga Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve, në rolin e saj të Sekretariatit të Komitetit të Investimeve Strategjike.
5. Ngarkohet Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve të vërë në dispozicion të ministrisë përgjegjëse për turizmin informacionin e nevojshëm lidhur me projektin e investimit.

6. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

ZËVENDËSKRYETAR I KOMITETIT TË INVESTIMEVE STRATEGJIKE

ZËVENDËSKRYEMINISTËR

SENIDA MESI